



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 02.07.2018

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS ME OBJEKT “PROJEKTIMI DHE REALIZIMI I PROJEKTIT URBAN DHE GODINËS SË RE TË TEATRIT KOMBËTAR”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 02.07.2018, mori në shqyrtim projektligjin “*Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”*”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti.

Në mbledhjet e Komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm Ministrija e Kulturës znj. Mirela Kumbaro, përfaqësues të kësaj ministrie, nënkryetari i Bashkisë Tiranë, z. Arbjan Mazniku dhe përfaqësues të këtij institucioni.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji është bazuar në nenin 78 dhe nenin 83 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Me anë të këtij projektligji synohet që të miratohet një procedurë e veçantë, për negociimin dhe lidhjen e kontratës për projektimin dhe zbatimin e projektit për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe realizimin e projektit për zhvillimin e një zone urbane në qytetin e Tiranës, me partner privat.

Nëpërmjet këtij projektinvestimi synohet krijimi i një godine të re për Teatrin Kombëtar, me standarde të larta evropiane, që do të japë ndikim dhe impakt të lartë në:

- krijimin e një hapësirë e re qytetare;
- përmirësimin e marrëdhënies me spektatorin, duke zgjeruar gamën e aktiviteteve dhe të hapësirave të reja alternative artistike;
- rritjen e kapaciteteve të veprimtarisë së Teatrit Kombëtar (Evropian);
- përmirësimin, në mënyrë të ndjeshme, të kushteve bazë për realizimin në kohë dhe me cilësi të premierave dhe repertorit të institucionit;
- rritjen e cilësisë profesionale, që mundëson vënien në skenë të veprave që kërkojnë infrastrukturë të konsoliduar dhe efikasitet, duke iu përgjigjur standardeve të artit bashkëkohor;
- rritje të projekteve që gjenerohen nga skena e pavarur artistike;
- sigurimin e parametrave optimalë në të gjithë sektorët e prodhimit e të administrimit;
- sigurimin e vazhdimësisë të aktivitetit artistik dhe realizimin në kohë të veprës;
- përmirësimin e infrastrukturës, si një domodoshmëri për mbarëvajtjen e punës dhe të veprimtarisë së Teatrit Kombëtar.

Bazë për incimin e këtij projektligji ka qënë shkresa, e paraqitur nga Bashkia Tiranë, pranë Ministrisë së Kulturës, lidhur me shprehjen e interesit për zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar, të subjektit “Fusha”, sh.p.k.

Në vlerësimin e projekt-propozimit, Ministria Kulturës në cilësinë e institucionit përgjegjës për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë, por edhe për garantimin e infrastrukturës për institucionet e kulturës, ka marrë në konsideratë sa më poshtë:

- Përfundimin e diskutimeve në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës në vitin 2004;
- Rezultat e inspektimit të kryer nga specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës, të zhvilluar në vitin 2014 nga Instituti i Ndërtimit, në aspekt të arkitekturës, strukturës dhe sistemeve teknike, vlerave të trashëgimisë kulturore dhe vlerësimit financiar. Referuar shpjegimeve në relacionin shoqërues argumentohet se:

“Kushtet aktuale të godinës së Teatrit Kombëtar nuk janë të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve për të cilat është projektuar dhe ambientet nuk ofrojnë kushte optimale jo vetëm për stafin, por edhe për spektatorët. Ndërhyrja në strukturën e objektit, sado e madhe të jetë, nuk e sjell atë në kushtet optimale teknike të sotme sipas kodeve të projektimit. Sistemet teknike janë jashtë normave të projektimit të godinave me karakter kulturor. Objekti i TK-së, vlerësuar nga ekspertët e fushës, nuk mbart vlera të spikatura të arkitekturës së kohës në të cilën është ndërtuar, kjo edhe për faktin se: a) objekti është ndërtuar në vitin 1938, si një objekt i përkohshëm, për të plotësuar shërbimet e kërkuara për një kryeqytet; b) objekti asnjëherë nuk është vlerësuar me status mbrojtjeje, si shumica e objekteve të ndërtuar në këtë periudhë në qytetin e Tiranës dhe së fundmi Ministria e Kulturës është shprehur që nuk disponon mjetet e mjaftueshme financiare për realizimin e këtij investimi, për më tepër, nuk e ka parashikuar këtë investim as në PBA (2018-2020).

- Statusin juridik të pronës, në zonën ku propozohet që të zhvillohet projekti, e cila ka një sipërfaqe prej 8 465 m², nga të cilat, rreth 2 100 m² janë pronë e Bashkisë së Tiranës.

Projektligji parashikon ngritjen e një komisioni për vlerësimin e propozimit të paraqitur nga investitori privat dhe negociimin e kushteve të kontratës, i cili do të kryesohet nga një përfaqësues i caktuar nga Bashkia Tiranë dhe në përbërje do të ketë përfaqësues nga disa institucione si dhe dy përfaqësues nga komuniteti i aktorëve. Komisioni i Negocimit propozohet të ketë një sërë kompetencash duke përfshirë:

- a) Vlerësimi i shprehjes së interesit nga partneri privat për zhvillimin e një zone urbane në qytetin e Tiranës dhe ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar;
- b) Negociimi me partnerin privat, shoqërinë “Fusha”, sh.p.k., të propozimit të paraqitur prej tyre dhe hartimi i kushteve të kontratës, shoqëruar edhe me relacionin përmbyllës të negociatave;
- c) Hartimi dhe administrimi i të gjitha procesverbaleve dhe dokumenteve të procedurës si dhe çdo dokumenti tjetër;
- ç) Realizimi i korrespondencave me institucionet e tjera, në vijim të negociatave, me qëllim marrjen e vlerësimit teknik për projektin.

Komisioni i negociimit parashikohet të asistohet në veprimtarinë e tij nga një konsulent i përzgjedhur sipas një procedure të veçantë, të përsheptuar, nga ana e Bashkisë së Tiranës që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Projektligji ka të parashikuar edhe elementët, që duhet të përmbajë kontrata e negociuar ndërmjet palëve. Në rastin e negociatave të suksesshme, Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, do të nënshkruajë kontratën, e cila do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u theksua impakti që do të ketë ky projektligj, në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe ofertës kulturore ndaj publikut, artdashësve dhe artistëve të artit skenik si dhe në garantimin e kushteve akomoduese dhe teknike-artistike në Teatrin Kombëtar.

Në prezantimin e këtij projektligji, përpara anëtarëve të komisionit, Ministria e Kulturës paraqiti një panoramë mbi gjendjen aktuale të Teatorit Kombëtar, investimet e kryera në katër vitet e fundit për rijetëzimin e teatrit në qytete të ndryshme të vendit, ndërhyrjet e pjeshme të kryera me qëllim sigurimin e kushteve teknike për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së teatrit Kombëtar. Sipas vlerësimit të propozuesit, projektligji i paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend ka këto përparësi:

- shteti realizon ndërtimit e Teatrit të ri Kombëtar në një kohë shumë të shpejtë (3 vjet), vetëm nëpërmjet dhënies të së drejtave për zhvillim dhe pa asnjë financim publik apo fond buxhetor.
- shteti nuk ka asnjë risk financiaro-ekonomik në lidhje me dhënien e të drejtave të zhvillimit të zonës dhe përfitimin e ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar. Për më tepër, shteti ka garanci ligjore, kontraktore dhe rregullatore, pasi në vijim të hyrjes në fuqi të ligjit të veçantë, përveç përvijimit në makro të procesit vijues, procedohet me ngritjen e komisionit shtetëror, që do të negociojë me investitorin sipërmarrës për të garantuar mirëfunksionimin e këtij propozimi dhe optimizimin e interesave të palëve, duke pasur në fokus maksimizimin e interesave publike;
- Shteti nuk është vetëm në rolin e pronarit të truallit, por, njëkohësisht në rolin rregullator, verifikues/kontrollues, ndëshkues, certifikues, regjistruar, etj. Procesi garanton transparencë në proces përgjatë të gjithë kohëzgjatjes dhe deri në përfundim.
- Investimi do të kryhet nga një partner serioz, me kapacitete, ekspertizë dhe eksperiencë të madhe në punimet e sipërmarrjes dhe që për më tepër, është i lidhur në mënyrë të konsoliduar me projektin, duke qenë se ka në pronësi një truall dhe objekt (selinë/zyrat e kompanisë së tij) në zonën afër teatrit.

Nga ana e deputëve u kërkuan sqarime në lidhje me mënyrën se si është vlerësuar propozimi i një procedure të veçantë negociimi për këtë projektligj dhe arsyet e moszbatimit të procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik dhe koncesionet dhe partneritetin publik privat. Nga përfaqësuesit e ministrisë së kulturës u sqarua se:

1. Asnjë prej institucioneve publike të parashikuara për ndjekjen e procesit dhe përfaqësimin e administratës publike në këtë projektligj nuk do të shpenzojnë fonde nga buxheti i shtetit.
2. Nëse analizohet qëllimi dhe objekti i ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat, rezulton e qartë se, në kuptim të këtij ligji, forma konsiston në marrëdhënien që krijohet në kushtet e këmbimit të investimit të privatit me të drejtën e shfrytëzimit të veprës publike të përfituar nga investimi privat, që shteti i jep atij. Në rastin konkret, propozimi nuk konsiston në shfrytëzim të veprës publike (godinës së re të Teatrit Kombëtar) të ngritur me investimin e privatit, pasi kjo vepër do të vazhdojë të jetë totalisht në shfrytëzim të subjektit publik, Teatrit Kombëtar.

Rasti konkret sipas shpjegimeve të propozuesve, nuk bën pjesë në fushën e zbatimit të legjislacionit të koncesioneve/PPP, pasi:

- a) investitori është pronar i një pjesë të sipërfaqes dhe i një godine, ku do të ndërtohet projekti;
- b) investitori nuk do të ketë shpërblim monetar, në asnjë vlerë, nga buxheti i shtetit;
- c) shteti do të bëhet pronar i godinës së Teatrit Kombëtar menjëherë me përfundimin e projektit,

Në përgjigje të pyetjeve të deputetëve në lidhje me afatin e përfundimit të projektit, kryerjen e një studimi paraprak fizibiliteti, kryerjen e një vlerësimi nga konsulentë ndërkombëtarë, vlerën e investimit, etj përfaqësuesit e ministrisë së kulturës, sqaruan se investimi që do të kryehet nga partneri privat është rreth 33 milion euro. U theksua se nëpërmjet këtij projektligji është kërkuar autorizimi i Kuvendit për fillimin e negociatave me partnerin privat, ndërkohë që të gjitha termat e kontratës, të drejtat dhe detyrimet e palëve, do t'i nënshtrohen negociimit dhe do të jenë pjesë e kontratës që do t'i paraqitet Kuvendit në një fazë të dytë, pasi projektligji parashikon hyrjen në fuqi të kontratës pas miratimit nga Kuvendi. Njëkohësisht propozuesit theksuan se projekt-propozimi i paraqitur nga investitori ka qënë pjesë e korrespondencës ndërmjet institucioneve dhe do të jetë pjesë e pandashme e kontratës.

Në vijim të shqetësimit të ngritur nga anëtarët e komisionit, lidhur me sipërfaqen e re të teatrit kombëtar, përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë sqaruan se sipërfaqja që përbën pronën e teatrit kombëtar, sipas dokumentit përkatës të pronësisë, lëshuar nga zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, do të jetë po ajo edhe pas përfundimit të ndërtimit të teatrit të ri dhe kjo çështje është e parashikuar shprehimisht në projektligj.

IV. NDRYSHIMET NEN PËR NEN

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji i sugjeron komisionit përgjegjës këto ndryshime:

Lidhur me nenin 5:

Në pikën 3 shprehja “komuniteti i aktorëve teatrorë” të zëvendësohet me shprehjen “trupa teatrore”.

Lidhur me nenin 6:

Shprehja “partner privat” i përdorur në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni të zëvendësohet me shprehjen “palë private”.

Ky sugjerim sugjerohet të reflektohet në të gjithë tekstin e projektligjit ku është përdorur ky term.

V. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

Adnor SHAMETI

Ulsi MANJA